

**AKTI I THEMELIMIT  
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“TUV Albania & Kosovo” shpk**

Sot, më 28.01.2024, ne, themeluesit,

- a) **Ivi Topi**, atësia Mentor, shtetas shqiptar, identifikuar me anë të kartës së identitetit me numër personal identifikimi J30502064T i datëlindjes 02.05.1993, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë ; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- b) **Eda Shuli**, atësia Irakli, shtetase shqiptare, identifikuar me anë të kartës së identitetit me numër personal identifikimi I56011048L, e datëlindjes 11.10.1985, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë; madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas kushteve të mëposhtëme.

**Neni 1  
Themelim**

- 1) Emri i shoqërisë është **“TUV Albania & Kosovo” shpk**.
- 2) Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 3) Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**Neni 2:  
Objekti**

- 1) Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:
  - a) Shoqëria mund të kryejë cdo aktivitet të lejuar me ligj në Republikën e Shqipërisë : Ofrim i shërbimeve të auditimit dhe certifikimit të sistemeve të menaxhimit (duke përfshirë, vetëm si shembuj por pa u kufizuar, sistemet e menaxhimit të cilësisë, mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë, energjisë, sigurisë, sigurisë së informacionit dhe ushqimore). Çdo veprimtari tjetër certifikimi me qëllim vërtetimin e konformitetit të produkteve, të sistemeve të menaxhimit, të proceseve dhe cilësive profesionale me kriteret vullnetare dhe të detyrueshme të parashikuara nga dispozitat e legjislacionit vendas, rregullat evropiane dhe ndërkombëtare, si dhe në direktivat e Bashkimit Evropian. Certifikimi i produktit. Inspektimi, auditimi, kontrolli teknik i produkteve, projekteve, shërbimeve, proceseve dhe sistemeve në lidhje me kërkesa specifike, të detyrueshme apo vullnetare; të gjitha në përputhje me standardet teknike ose me dispozitat e veçanta sipas zonave, direktivat dhe rregulloret e Bashkimit Evropian si dhe standardet e tjera përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare. Ofrimi i trajnimeve dhe kualifikimeve për standardet ISO dhe Standardet Shqiptare (SSH). Për veprimtari të tilla shoqëria mund të kerkojë çdo lloj akreditimi, certifikimi, kualifikimi, autorizimi e liçencimi për të ushtruar në Shqipëri apo jashtë vendit.

**Neni 3:  
Kohëzgjatja**

- 1) Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

**Neni 4:  
Selia**



Faqe 1 e 2  
Akti i Themelimit

TUV Albania & Kosovo shpk



- 1) Shoqëria e ka selinë në: Rruga Mihal Grameno, Pallati: 11, Shkalla 1, Hyrja 1, Tiranë.
- 2) Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

#### **Neni 5**

#### **Kapitali themeltar**

- 1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 10 000 (dhjetë mijë) Lekë dhe është i ndarë në 2 (dy) kuota. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
  - a) Ortaku themelues Ivi Topi, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 5 000 (pese mijë) Lekë, që përben 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
  - b) Ortaku themelues Eda Shuli, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 5 000 (pese mijë) Lekë, që përben 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 2) Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

#### **Neni 6**

#### **Organet Drejtuese**

- 1) Organet drejtuese të shoqërisë janë:
  - a) Asambleja e Ortakëve,
  - b) Administratori i shoqërisë.

#### **Neni 7**

#### **Baza Ligjore**

- 1) Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plote me statutin dhe dispozitat e legjisllacionit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet në statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

#### **Neni 8**


#### **Mosmarrëveshjet**

- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

**ORTAKËT**  
**E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"TUV Albania & Kosovo" shpk**



(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)



(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)